




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Nr.4 regjistri datë 18.2.2015  
Nr.4 vendimi datë 24.2.2015



VENDIM  
NË  
“EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata administrative e shkallës së parë Shkodër e përbërë nga :  
Ahmet JANGULLI GJYQTAR

Asistuar prej sekretares Entela Hasmujaj, në Shkodër në datën 24.2.2015, shqyrtoi në seancë gjyqësore/ të hapur, çështjen e veçantë administrative nr.4 akti/ që i përket :

**Kërkues :**

Franc Shelqetja i biri i Ludovokut dhe i Margarites i datl.11.2.1990, banues në fshatin Barbullush, të komunës Bushat, Shkodër, i martuar, me arsim të mesëm, i punësuar, me shtetësi shqiptare, i njohur me letërnjoftimin me nr.024572472 e me nr. personal J00211087V.

I mbrojtur në gjykim/ me deklaram në seancë, nga av. Niazi Sinani/ me nr. Leje 1492 e me nr. Nipt i L46426009L.

**Ndaj palëve :**

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (Drejtoria e Apelit Tatimor) Tiranë. Adresa: Rruga “Gjin Bue SHpata”, pranë stadiumit “Dinamo”, Tiranë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder. Adresa: Lagjia “Parrucë”, pranë Xhamisë, Shkodër.

E përfaqësuar në gjykim/ me shkresën nr.1597 prot datë 24.2.2015, nga juristja Sirjana Bakushi/ e njohur me letërnjoftimin me nr.024589376 e me nr.personal H75426117F.

**Objekti :**

Per sigurimin e padisë e cila do të paraqitet në gjykatë me object per zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushen e tatimeve mbi pavlefshmerinë e aktit administrative, vendim nr. 28091/3 datë 16.1.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë dhe njoftim

Shkollë e Shkollës  
vlerësimi nr. 8120/ 52 datë 8.10.2014 per vendosje gjobe në masen 100.000 (njëqind mijë) lekë.

**B. Ligjore :**

Ligji 49/ 2012 “per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, neni 28 “sigurimi i padisë”, pika 2, neni 29 “Kushtet per sigurimin e padisë”, neni 30 “Llojet e masave per sigurimin e padisë”.  
Ligji 9920 datë 19.5.2008 per procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 109 pika 2 e tij.

Gjykata gjatë gjykimin, në pranë të palëve, ku pala kërkuese/ *hoqi dorë nga gjykimi*, e si shqyrtoi aktet shkresore në tërësi.

**V Ë R E N**

**I.**

1. Se, pala kërkuese ka vënë në lëvizje gjykatën me kërkesë/ duke pretenduar sipas objektit.

1.1. çështja është paraqitur për gjykim në datën 18.2.2015.

**II. Rrethanat e faktit:**

3. Në seancë/ në fazën e parashtrimit të kërtimeve dhe kërkesave për prova, pala kërkuese/ *hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës*.

**III. Vlerësimi i gjykatës:**

4. Në këto rrethana/ gjykata e çmon se, duhet vendosur pushimi i gjykimin të çështjes.

Sa sipër provohet me aktet shkresore dhe gjithë dokumentacioni në dosje.

**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata në bazë të nenit 299 gërma b)/ për nenin 201 § 1 të k.pr.civile, dhe nenit 39 pika 3 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**V E N D O S I**



Pushimin e gjyqimit në çështjen e veçantë administrative nr.4 akti, datë 18.2.2015, që është ngritur nga pala kërkuese Franc Shelqetja, për shkakun se hoqi dorë nga gjykimi.

Shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen palës kërkuese Franc Shelqetja.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë, në gjykatën administrative të apelit Tiranë.

U shpall në Shkodër me 24 shkurt 2015.

**SEKRETARE**  
Entela HASMUJAJ

**GJYQATAR**  
Ahmet JANGULLI

Shpenzime gjyqësore:	
Taks mbi akte	200 lekë,
Njoftime	200 lekë,
Akte – Letër	50 lekë,
Shuma	450 lekë.

**Sekretare**  
Entela HASMUJAJ

VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË  
SOT ME DATË. 03.03.2015

KANCELARE  
BELERTA NURJA

